

VENDIM
Nr. 39, datë 16.10.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR PROGRAMIN “INFRASTRUKTURË
VENDORE DHE RAJONALE”, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMET E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE NR.18, DATË
19.11.2014, NR.5,
DATË 9.2.2015, DHE NR.22,
DATË 8.5.2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte për programin “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe institucionet e organizatat për zhvillim, agjencitë zbatuese e zhvillimore, qendrore e vendore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e të përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, deri në fillim të muajit dhjetor, të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprokuruar, sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe të rishpërndajë fondet e këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi.

5. Në tabelën nr. 4, që i bashkëlidhet vendimit nr. 18, datë 19.11.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshime, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 5, datë 9.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshime, sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 22, datë 8.5.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshime, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama